



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LUSHNJE  
QENDRA E ARSIMIT**

Data 28.02.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“BLERJE BUKE, ARTIKUJ BULMETORE, ARTIKUJ USHQIMORË DHE FRUTA PERIME, MISHI  
DHE NËNPRODUKTE TË TIJ PËR NEVOJAT E KOPSHTEVE, ÇERDHES DHE KONVIKTIT”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

15100000-9, 03221000-6, 155421000-0, 15511000-3, 15111200-1, 03221113-1, 03222321-  
9, 15612210-6, 15332290-3, 03221220-4, 154111-6, 03211600-9, 032121000-1, 03212211-  
2, 03212212-9

---

**VLERA E FONDIT LIMIT: 13, 362, 686 (trembedhjetë milion e treqind e  
gjatedhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lek pa TVSH.**

Ne baze të nenit 76 pika 1 germa b) VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Në përlogaritjen e vlerës limit të

kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimete e tregut , bazuar ne mesataren e cmimeve te marra nga ky studim ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;
- d) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

➤ **Grupi i punes, i ngritur me urdher te brendshem Nr.04 date 21.02.2024, u mbeshtet në testimin e tregut me ane te procesverbaleve te hartuar duke mare tre çmime te ndryshme te produkteve dhe duke bere nje mesatare per te llogaritur fondin limit.**

### **Fondi Limit**

**Argumentimi:** Perllogaritja e vleres se fondit limit i jemi referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021 të ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Qendra e Arsimit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

c. *Formulari ofertës sipas shtojcës 1,2*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të **Nenit 26** "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

**Neni 82,** i LPP "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

**Neni 83 i LPP** "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*1. Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit ...

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga Operatori ekonomik gjatë 3 (tre) viteve të fundit ( **2020,2021,2022**) të leshuar nga Administrata Tatimore ku

vlera e xhiros duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet**". Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuara se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; , si dhe **nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"**. ku përcaktohet se: Në **Pika 1.** Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. **Pika 2/b:** 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: *b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë është përcaktuar referuar nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2** Kopje të çertifikuara të **bilanceve të 3 (tre)** viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**

Kerkohe për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë Op.ekonomik të vegjel apo të medhenj.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për **vitin 2023** pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

***Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. **Ne kete rast në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .**

**Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:**

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme **të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:  
Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të realizuar shërbimin e kërkuar, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të **jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar**. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim **që Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojës se meparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftesine teknike per te realizuar shërbimin sic eshte parashikuar nga AK.**

---

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar minimalisht **3 (tre)** punonjes nder te **cilet 1 shofere dhe 2 punetor** per te gjithë periudhen e zbatimit te MK (kjo per arsye se operatori ekonomik duhet te marre persiper shperndarjen ditore te ushqimeve ne kopshtet ,çerdhet , konviktin), e vertetuar me listpagesa.(Per te cilet Ofertuesi duhet te paraqese: Kontrate Pune dhe per 1(nje) nga punonjesit( perkatesisht shoferi ) duhet te paraqese edhe leje drejtimi mjetei .

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore te nevojshme për ekzekutimin e kontrates, objekti i prokurimit në fjalë është një kontratë furnizimi e cila per disa nga produktet, si buka, frutra-perime dhe artikujt ushqimore me origjine shtazore do te kryhet furnizimi ditor duke shparndare ne te gjithë destinacionet e kerkuara nga AK si kopshtet, cerdhja dhe konvik ne teritorin e Bashkise Lushnje. Kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës

***Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe***

**dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.**

**Kriteri 2.3.2.** eshte vendosur ne baze te pikes 4, te nenit 77 te ligjit nr,162 date 23.12.2020” Për prokurimin publik”,dhe neni 40, pika 5/c, te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomik, te deshmojne qe kane fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin dhe realizimin me sukses te objektit te prokurimit, qe kane ne dispozicion apo qe mund ti vihen.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate duhet te jete i pajisur dhe te paraqese çertifikatat perkatese te vlefshme **per gjithe periudhen e realizimit te kontrates:** si me poshte:

*a) Çertifikate ISO 9001:2015 ”Per menaxhimin e cilesise”objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.*

*-b)Çertifikate -ISO 22000 :2018 ”Per sistemin e Menaxhimit te Sigurise Ushqimore”objekti i se ciles te jete ne perputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.*

***Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.***

- **1 mjet** duhet te jene **ATV frigorifer** per transportin e produkteve si **mishi dhe bulmeti** dhe **1 mjete** per transportin e **produkteve ushqimore**, ne pronesi ose me qera, te vertetuar me dokumentacionin perkates;

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.



**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

***Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.***

- Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qera ose në përdorim sipas kontratës materiale, ambiente të përshtatshme, **Magazine ushqimore dhe ambiente frigoriferike në qytetin/rrethin e Lushnjës** me për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës:

Ambjentet duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë :

1-Akt –miratimi higjieno- sanitar, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor (ISHSH).

3-Deklarate nga Operatori Ekonomik që ambienti i plotëson kriteret e kerkuara.

- ❖ Duke qenë se shërbimi i kërkuar nga autoriteti kontraktor ka një grafik shpërndarje ushqimi pranë kopshteve me drek, çerdheve, dhe konviktit në territorin e Bashkisë Lushnje gjatë gjithë ditës, me orare të ndryshme shpërndarje, për këtë arsye është kërkuar një objekt aktiviteti në pronesi ose me qera në Qytetin e Lushnjës, pasi ushqimet terhiqen nga ky objekt fizik dhe pastaj bëhet shpërndarja në të gjithë territorin gjatë gjithë ditës së punës

dhe ne orare te ndryshme. Kjo per te realizuar nje sherbim sa me efikas dhe ne te mire te femijeve te kopshteve, çerdheve, konvikt

- ❖ Ky kriterere eshte bere ne përputhje dhe me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, date 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterereve te veçanta per kualifikim dhe specififikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, te Agjencise se Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit, publikuar ne adresen [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

**- Dokument që ka në pronësi ose në përdorim, ose kontrate furnizimi me furre buke,** me nje subjekt prodhues i cili te tregojë lidhjen e zyrtarizuar te noterizuar midis Operatorit ekonomik dhe prodhuesit me nje subjekt prodhues, ku ky i fundit duhet te permbaje te dhenat e plota si licence, telefoni, email., diplome, CV dhe libreze shendetesore. (Ne rastet kur subjekti ka kontrate furnizimi, duhet te siguroje dhe te dokumentoje furnizimin (vetem kontraten) ne vijimesi per gjithe periudhen e kerkuar, për realizimim sa me te sukseseshem te kontrates dhe jo licencat e kerkuara.)

Ambjenti duhet te jete i pajisur me :

- Licence QKL me kodin II.1 A (1)
- Leje higjeno sanitare,

**-Dokument që ka ne pronesi ose ne perdorim, ose kontrate furnizimi** ( ne kete rast duhet te siguroje dhe te dokumentoje furnizimin (vetem kontraten) ne vijimesi per gjithe periudhen e kerkuar, për realizimim sa me te sukseseshem te kontrates dhe jo licencat e kerkuara.

me thertore te noterizuar te pajisur me:

- Leje higjeno sanitare
- Leje mjedisore me kodin III.1.B( therje kafshesh)
- Licence leshuar nga (QKL) me kodin II.A(1). (thertore).
- Per thertoren duhet te paraqitet vertetim nga AKU qe eshte funksionale ( ne kuader te nismave qeveritare ne kete fushe)

**- Dokument që ka ne pronesi ose ne perdorim, ose kontrate furnizimi ( ne kete rast duhet te siguroje dhe te dokumentoje furnizimin (vetem kontraten)**

ne vijimesi per gjithë periudhen e kerkuar, për realizimim sa me te sukseseshem te kontrates dhe jo licencat e kerkuara.

te noretizuar me **njesi prodhimi bulmeti** te noterizuar te pajisur me:

- Leje higjeno sanitare
- Leje mjedisore me kodin III.1.B( per trajtimin dhe pepunimin e qumshtit )
- Licence leshuar nga (QKL) me kodin II.1.A(1). Dhe II.1.B.

- **Dokument që ka ne pronesi ose ne perdorim, ose kontrate furnizimi( ne kete rast duhet te siguroje dhe te dokumentoje furnizimin ( vetem kontraten) ne vijimesi per gjithë periudhen e kerkuar, për realizimim sa me te sukseseshem te kontrates dhe jo licencat e kerkuara.**

te noterizuar me **kompleks stallor** te pajisur me:

- Leje mjedisore me kodin III.1.B( per mbarshkrim kafshesh )
- Licence leshuar nga (QKL) me kodin II.3.A dhe II .3 C

-**Dokument që ka ne pronesi ose ne perdorim, ose kontrate furnizimi ( ne kete rast duhet te siguroje dhe te dokumentoje furnizimin ( vetem kontraten) ne vijimesi per gjithë periudhen e kerkuar, për realizimim sa me te sukseseshem te kontrates dhe jo licencat e kerkuara.**

te noretizuar me **kompleks pularie** te pajisur me:

- Licence leshuar nga (QKL) me kodin II.1.A.1(prodhim,ambalazhim, etiketim e shperndarje me shumice e vezeve)
- II.1.B(shitje me shumicee ushqimeve me orgjine shtazore per njerz)

Kriteret e mësipërme janë vendosur bazuar në **pikën 4, të nenit të 77, të ligjit** Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” **dhe nenit 40, pika 5, të VKM** nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Gjithashtu perzgjedhja e ketyre kriterëve eshte bere ne përputhje dhe me **Rekomandimin Nr. 10181 Prot, date 19.11.2018**, “Rekomandim mbi hartimin e

kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, publikuar në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

***Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.***

## **2.4 KAPACITETI LIGJOR/PROFESIONAL I OPERATOREVE EKONOMIK**

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**1-Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, kodi:II.1.A.(1)“Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë”.**

**2-Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, kodi II.1.B . Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njëzë .**

- **Argumentimi: Kërkesat e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “ Për prokurimin publik, nëni 40 pika 5 germa a) të VKM-së nr 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Pika III Hartimi i Kritereve të Veçanta për Kualifikim,**
- **Rekomandimit të përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nr. 10181 prot dhe 8514 prot datë 19.11.2018 Ku citohet gjithashtu që:..Autoriteti Kontraktor do të mbaje në konsideratë faktin se, nuk lejohet përdorimi i Licencës të një Operatori tjetër ekonomik.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**